

## **Koferenca Regjionale në Mal të Zi me temë 'Mbrojtja e të Dhënave Personale dhe Liria e Informimit'.**

### **TEZA: Qasja në Dokumente Zyrtare dhe Mbrojtja e të Dhënave Personale (shembulli i Kosovës)**

Më lejoni që, në emër të ASHMDH-së të Republikës së Kosovës, të përshëndes të gjithë të pranishmit në këtë konferencë.

Njëkohësisht, falenderoj organizatorët për ftesën që i kanë bërë Agjencisë për Mbrojtjes së të Dhënave e Republikës së Kosovës, që të jetë pjesëmarrëse e kësaj konference.

Tema boshte e kësaj konference: "Qasja në informacion dhe mbrojtja e të dhënave personale", pa dyshim se është temë me rëndësi të posaçme.

Fillimisht, dua të theksoj që qëndron konstatimi se të dhënat personale dhe privatësia e individit janë në thelb parime fundamentale të lirisë, paqes, sigurisë, besimit, drejtësisë dhe lirive themelore të njeriut. Kështu, para se të kaloj në një çështje shumë të rëndësishme e që ne në Kosovë e kemi trajtuar, dëshiroj të theksoj se shikuar nivelin e zhvillimit teknologjik të informimit që përdoret për përpunimin automatik të të dhënave personale në fusha të ndryshme, mund të konstatohet se brenga numër një dhe preokupimi ynë me proiritet në nivel rajonal do të duhej trajtuar mbrojtja e të dhënave personale dhe privatësia e individit.

Në këtë grumbull kaq të madh të pajisjeve që janë prodhuar për njeriun, për jetën e tij dhe "kundër tij" dhe lansimin e tyre për përdorim, në tokë dhe ajër, në aspektin e përgjimit, vëzhgimit, inçizimit, shikimit apo monitorimit; për individin, lirisht mund të themi se të dhënat e personale, pa pëlqimin dhe dëshirën e individit, ndodhin kudo dhe kurdo.

Përveç këtyre të arriturave teknologjike të shekullit të ri që hap pas hapi gjurmojnë dhe ndjekin individin, del se legjislacionet në fuqi dhe ai që do të na imponohet kërkon rregulla të reja të sjelljes në fusha të caktuara të veprimeve standarde rreth qartësimeve të vijave të ndërveprimeve ligjore.

Në këtë kontekst, shtrohet pyetja se çfarë kërkon ligji për informim? Sigurisht se gjithçka për individin dhe jetën e tij, në emër të informimit të drejtë dhe objektiv, në interes të publikut. Por, cili është ky interes dhe ku përfundon e drejta e informimit? Në cilat raste? A ka diçka që nuk kumtohet asnjëherë pa lejen dhe autorizimin e subjektit të të dhënave personale? Sigurisht se po. Kjo është "privatësia".

Po ku qëndron e drejta për t'u qasur në dokumente zyrtare-publike? Patjetër në shërbim të qytetarëve dhe në luftë kundër keqpërdorimeve. Publikimi dhe hapja e dokumenteve është në funksion të evitimit të dukurive korruptuese të individit.

Në bazë të hulumtimeve të bëra, tashmë një numër i konsiderueshëm i qytetarëve të Kosovës kanë njohuri për ligjin dhe të drejtat e tyre për qasje në dokumente zyrtare<sup>1</sup>. Por, në bazë të bindjeve tona, qytetarët janë gjithashtu të njoftuar rreth Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Të trija këto ligje, në shumicën e vendeve të BE-së, menaxhohen nga autoritetet e pavarura që direkt i raportojnë kuvendit të shtetit (asamblesë nacionale). Ndërkaq, në Kosovë, aktualisht po punohet në harmonizimin e plotë të këtyre ligjeve me ligjet evropiane (*Acquis Communautaire*) (Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ligji për Qasje në Dokumentet Publike janë në procedura të amandamentimit).

Ligji i Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka autoritetin e pavarur të themeluar dhe ndërtuar nga Kuvendi i Kosovës, të cilit i raporton. Ndërsa, Ligji për Qasje në Dokumente Zyrtare, i menaxhuar nga Avokati i Popullit i Kosovës (i raporton Kuvendit të Republikës), autoritetin që ekzekuton me këtë ligj e ka në qeveri, në drejtorin për informim të Qeverisë dhe ky lloj "sharmi organizativ" përbën konflikt interesesh. Gati në të gjitha vendet demokratike, Ligji për Qasje në Dokumente Publike menaxhohet ose në mënyrë të pavarur, plotësisht me autoritet e veçanta, ose është në kuadër të autoriteteve për mbrojtjen e të dhënave personale, si në (Slloveni, Mal të Zi, Maqedoni, Zvicër, etj). Ne, përmes Avokatit të Popullit, kemi rekomanduar për ikje nga konflikti i interesit, që menaxhimi i këtij ligji, të jetë i pavarur, ose t'i kalojë autoritetit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Zonja dhe zotërinj,

Do të doja që, përmes një shembulli, të theksoj ndërvarësinë dhe ndërthurjen ligjore të këtyre tri ligjeve, që fokus i kanë të dhënat personale dhe privatësinë e individit, por në shfrytëzim janë: e drejta e informimit, e drejta për qasje në dokumente zyrtare dhe e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale.

Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë (BIRN), në vitin 2011 kishte kërkuar qasje në dokumente zyrtare të Qeverisë në faturat e shpenzimeve të Kryeministrit, Zv. Kryeministrit dhe disa ministrave. Fillimisht, Zyra e Kryeministrit ka dhënë

---

<sup>1</sup> Gazeta e përditshme "Koha Ditore", e datës 29 shtator, artikulli "Qytetarët të paiterësuar për qasje në dokumente zyrtare", autor: Gent Mehmeti, faqe 8.

informacionet për shpenzimet e kërkuara, në mënyrë kumulative, disa anëtarë të kabinetit i kanë dhënë edhe fakturat. Mirëpo, duke mos u kënaqur me transparencën, BIRN-i (organizatë joqeveritare - Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë) kërkon ndërmjetësimin nga Avokati i Popullit për të marrë të gjitha faturat e shpenzimeve, pa marrë parasysh llojin e tyre (të udhëtimeve, të fjetjes, të ushqimit, të pijeve, etj). Përsëri, Zyra e Kryeministrit, sipas kërkesës së BIRN-it dhe Avokatit të Popullit ofron shpenzimet kumulative por nuk i jep faturat, duke konsideruar se kjo përbën shkelje të privatësisë.

Avokati i Popullit, në presionin e vazhdueshëm të kërkesave të BIRN-it, me një shkresë i drejtohet institucionit tonë, me anë të së cilës kërkon opinionin tonë.

Duke u mbështetur në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjin për Qasje në Dokumente Zyrtare, Ligjin e Lirisë së Informimit, Kodin Penal të Republikës së Kosovës, Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, nenin 8 të saj, Direktivën Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Privatësisë, Kushtetutën e Republikës së Kosovës; Agjencia, në opinionin e vet konstatoi se hapja e faturave përbën shkelje të privatësisë, ngase bëjnë të mundur identifikimin e personit duke nxjerrë:

- Të dhënat për të,
- Të dhënat në lidhje me të,
- Të dhëna të rëndësishme për të,
- Të dhëna të cilat kanë fokus atë,
- Të dhëna që kanë çfarëdo ndikimi me të.

Mirëpo, duke qenë në respektim të shpenzimit të parasë publike dhe transparencës, në shpenzimin e taksës së qytetarëve, Agjencia kërkoi në këtë opinion që të gjitha shpenzimet e strukturuar të bëhen publike dhe për këtë qëllim të përgatiten tabela dhe forma të caktuara që tregojnë shpenzimet e bëra sipas natyrave shpenzuese.

Ndërkaq, duke qenë në përputhje të konkurrencës së lirë dhe të paanshme, Këshilli i Agjencisë, me këtë opinion dha mendimin e vet se nuk do të ishte ligjore nëse do të bëhej publike emërtimi i aviokompanisë fluturuese, i vendit të ushqimit apo vendit të fjetjes nga se do të ndikohej në aspektin e marketingut favorizues dhe jo të barabartë të kompanive dhe të tregut të punës.

Opinionin i bërë publik në faqen e Agjencisë dhe i dërguar te Avokati i Popullit nuk u prit mirë nga ana e BIRN-it, dhe një kohë ASHMDHP ishte bombarduar me kërkesa të drejta e të padrejta nga ana e këtyre gazetarëve, gjoja në emër të "Mbrojtjes së të Dhënave Personale", në e kuptuam se bëhej fjalë për një shantazh tepër të ulët gazetaresk dhe aspak etik, ngase nuk ishin kënaqur ambicjet e kërkesave të skajshme të BIRN-it në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ky rast, të cilin e kam përshkruar, nuk ka ngjarë në regjion, mund të shërbejë si punë e mëtejme dhe harmonizimit të qëndrimeve të lidhura me rastin, gjegjësisht lidhur me autoritetet e larta politike.

Zonja dhe zotërinj,

Të nderuar organizatorë të kësaj konference, në bashkëpunim të ngushtë me Bashkimin Evropian, me sukses u arrit qëllimi rreth pyetjeve të shtruar për shqyrtim në këtë tubim.

Dua që në fund të përcjell te të gjithë ju përshëndetje të përzemërta nga Agjencia më e re për mbrojtjen e të dhënave personale në regjion, gjegjësisht Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nga Republika e Kosovës, duke dëshiruar që në këtë mënyrë të përcjell mesazhin e unifikimit të standardeve në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe të privatësisë, për shkak se të dhënat personale dhe privatësia nuk kanë kufij, ato lëvizin bashkërisht me individin, nuk kanë përcaktim politik, e as përcaktim fetar. Në këtë mënyrë forcojmë zërin tonë në projektet tona të përbashkëta në nivel të Bashkimit Evropian. Njëkohësisht, ndërtojmë standarde dhe praktika të përbashkëta, duke krijuar kushte për integritet në mekanizmat evropatlantike, duke ngritur kështu vetëdijen në drejtim të sundimit të ligjit, sigurisë së përgjithshme dhe lirive themelore të njeriut.

Ju faleminderit !

Përfaqësuar nga:

z. Ruzhdi JASHARI

Mbikëqyrës Kryesor Shtetëror

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale